

## Neni 77

Titulli i pjesës së tetë bëhet “INFRASTRUKTURA E ZGJEDHJEVE”

## Neni 78

Titulli i kreut I të pjesës së tetë bëhet “ORGANIZIMI I INFRASTRUKTURËS SË ZGJEDHJEVE”

## Neni 79

Neni 93 ndryshohet si vijon:

“Neni 93

Zonat e Administrimit Zgjedhor (ZAZ)

1. Zonat e Administrimit Zgjedhor funksionojnë për çdo lloj zgjedhje dhe referendum, sipas këtij ligji.
1. Shtrirja e ZAZ-ve, si rregull, është e njëjtë me territorin administrativ të bashkisë, sipas ligjit që rregullon organizimin administrativ-territorial të Republikës së Shqipërisë. Bashkitë që kanë më shumë se 80 mijë shtetas me të drejtë vote ndahen nga KQZ-ja në më shumë se sa një ZAZ, në përputhje me kriteret e mëposhtme:
  - a) pandashmëria e territorit të njësisë administrative, përjashtuar ato me më shumë se 80 mijë zgjedhës;
  - b) vazhdimësia dhe kompaktësia e territorit, duke shmangur barrierat gjeografike;
  - c) mundësi të mira komunikimi brenda territorit;
  - ç) numër i përafërt zgjedhësish.
3. Asnjë ZAZ nuk mund të shtrihet gjeografikisht në dy ose më shumë qarqe.
4. Për Bashkinë e Tiranës, secila nga njësitë bashkiake përbën ZAZ më vete.
5. ZAZ-të miratohen nga KQZ-ja jo më vonë se 9 muaj para përfundimit të mandatit të Kuvendit, mbi bazën e numrit të shtetasve me të drejtë vote në datën e fundit të periudhës zgjedhore për caktimin e zgjedhjeve, sipas të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile. Jo më vonë se 10 muaj para mbarimit të mandatit të Kuvendit, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile i dërgon të dhënat KQZ-së, të ndara sipas njësive të qeverisjes vendore dhe njësive administrative të përfshira në to.
6. KQZ-ja, jo më vonë se 5 muaj para datës së zgjedhjeve, mund të ndryshojë kufijtë e ZAZ-së, sipas kërkesave të këtij neni, vetëm nëse ka ndryshim të kriterëve për caktimin e tyre sipas pikave 2 dhe 3 të këtij neni.

## Neni 80

Neni 94 ndryshohet si vijon:

### Neni 94

#### Zona e qendrës së votimit

1. Zona e qendrës së votimit duhet të jetë brenda një territori kompakt dhe të pashkëputur gjeografik dhe numri i zgjedhësve për çdo qendër votimi nuk duhet të jetë më i vogël se 200 dhe më i madh se 1,000 zgjedhës.
2. Institucionet e posaçme përbëjnë zonë të veçantë qendre votimi. Qendra e votimit në këto institucione ngrihet kur në to ndodhen mbi 15 zgjedhës.
3. Kufijtë ekzistues të zonës së qendrës së votimit nuk ndryshojnë, me përjashtim të rastit kur bëhet i domosdoshëm ndryshimi për shkak të mosplotësimit të kushteve të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.
4. Kur një zonë qendre votimi ka më shumë se 1,000 zgjedhës dhe lista është ndarë sipas **nenit 51 të këtij ligji**, kryetari i njësisë së qeverisjes vendore vendos krijimin e qendrës shtesë të votimit brenda së njëjtës zonë. Në këtë rast qendra e re e votimit ngrihet, për sa është e mundur, në të njëjtën godinë me qendrën ekzistuese të votimit dhe numërohet sipas sistemit unik kombëtar të numërtimit të qendrave të votimit.
5. Kur një zonë qendre votimi ka më pak se 200 zgjedhës, kryetari i njësisë së qeverisjes vendore vendos që ajo t'i bashkohet zonës së qendrës së votimit me numër më të madh zgjedhësish, më të afërt dhe me mundësi komunikimi rrugor. Si rregull, qendra e re e votimit nuk është më larg se 5 km nga qendra e votimit që shkrihet për zonat rurale. Në rast se nuk është e mundur të zbatohen të dy kriteret e mësipërme, kriteri i numrit minimal të zgjedhësve ka përparësi. Numri i qendrës së votimit të shkrirë pezullohet dhe ky pezullim nuk ndikon në numërtimin ekzistues të qendrave të tjera të votimit. KQZ-ja përcakton me akt normativ kriteret dhe procedurat për bashkimin e qendrave të votimit, në përputhje me këtë pikë.
6. Jo më vonë se 10 ditë nga përcaktimi i qendrës së votimit, sipas këtij neni, kryetari i njësisë vendore është i detyruar të njoftojë KQZ-në. Njoftimi për vendndodhjen shoqërohet edhe me planimetrinë, llojin e objektit dhe informacione të tjera të përcaktuara në aktin normativ të KQZ-së.
7. Mbi bazën e informacionit të marrë nga kryetarët e njësisë të qeverisjes vendore, në zbatim të këtij neni, KQZ-ja krijon dhe përditëson hartën e zonave të qendrave të votimit, si dhe krijon bazën e të dhënave mbi vendndodhjet e qendrave të votimit. Përfaqësuesit e partive politike të akredituara në KQZ kanë të drejtë të njihen në çdo kohë me to.
8. KQZ-ja, brenda afateve të përcaktuara në këtë nen, ndërhyr kryesisht ose me ankesë të përfaqësuesve të partive në KQZ, për të zbatuar kërkesat dhe kriteret për qendrën e votimit,

numrin e zgjedhësve dhe vendndodhjen e tyre. Pas vendimit të KQZ-së qendra e votimit nuk ndryshon.

9. Në rast të refuzimit të zbatimit të urdhërimeve të KQZ-së në lidhje me qendrat e votimit, KQZ-ja ndëshkon kryetarin e njësisë vendore me 50,000 deri në 100,000 lekë gjobë, si dhe njofton prefektin për zbatimin e vendimit për caktimin e qendrave të votimit. Gjoha përbën titull ekzekutiv.

## Neni 81

Neni 95 ndryshohet si vijon:

“Neni 95

Vendndodhja e qendrave të votimit, selive të KZAZ-ve  
dhe Vendeve të Numërimit të Votave

1. Si rregull, qendrat e votimit, selitë e NjAZ-eve dhe VNV-të caktohen në ndërtesa publike me hyrje të lirë, në të njëjtën adresë, brenda ZAZ-së përkatëse, me atë të zgjedhjeve të fundit.
2. Qendrat e votimit, selitë e KZAZ-ve dhe VNV-të nuk mund të ngrihen:
  - a) në ndërtesa private, pa miratim të KQZ-së. Në çdo rast qendra e votimit nuk mund të caktohet në banesa private;
  - b) në ndërtesa që përdoren nga administrata publike, me përjashtim të institucioneve arsimore, kulturore dhe shëndetësore;
  - c) në ndërtesa që përdoren apo janë në pronësi, pjesërisht ose tërësisht, të një partie politike, kandidati, të afërmeve të tij, ose kanë shërbyer si zyra elektorale gjatë fushatës zgjedhore.
3. Qendrat e votimit caktohen dhe shpallen nga kryetari i bashkisë, në përputhje me kriteret e përcaktuara në **nenin 94 dhe në këtë nen**, jo më vonë se 30 ditë nga dekretimi i datës së zgjedhjeve. Vendndodhja e qendrës së votimit nuk mund të ndryshojë në 40 ditët e fundit para datës së zgjedhjeve, përveç rasteve kur, për shkak të forcave madhore, ndryshimi autorizohet nga KQZ-ja.
4. Qendrat e votimit caktohen në salla me hapësirë të mjaftueshme për organizimin e rrjedhshëm të procesit të votimit, që garantojnë fshehtësinë e votimit dhe që lejojnë vëzhgimin e lirshëm të procesit nga përfaqësuesit dhe vëzhguesit e akredituar. Përveç dhomave të fshehta të votimit, sallat ku vendosen qendrat e votimit nuk duhet të kenë barriera pamore për zyrtarët zgjedhorë, përfaqësuesit dhe vëzhguesit e akredituar.
5. Selitë e NjAZ-eve dhe VNV-të caktohen dhe shpallen nga KQZ-ja, në përputhje me kriteret e përcaktuara **në këtë nen**, jo më vonë se 40 ditë nga data e zgjedhjeve. Për caktimin e tyre,

KQZ-ja përzgjedh nga lista e plotë e objekteve publike brenda territorit të qarkut, që i paraqitet nga prefekti i qarkut, të cilat plotësojnë kushtet sipas këtij neni.

6. VNV-të caktohen në salla me përmasa të mëdha ose palestra sportive. Për caktimin e VNV-së, KQZ-ja i jep përparësi lehtësive logjistike të transportit rrugor, distancës më të përshtatshme nga qendrat e votimit, hapësirave të bollshme për kryerjen e veprimtarisë dhe për vëzhgimin optimal të procesit, si dhe mundësisë për kushte sigurie më të larta. Në varësi nga këto rrethana, KQZ-ja mund të caktojë VNV-në jashtë territorit të ZAZ-së, nëse nuk ka ndërtesat publike brenda ZAZ-së, të cilat plotësojnë kushtet e këtij neni.
7. VNV-të vihen në dispozicion të NjAZ-eve jo më vonë se 10 ditë para datës së zgjedhjeve, të pajisura me të gjitha mjetet e nevojshme logjistike dhe teknike për kryerjen e procesit. Një VNV nuk mund të ketë më pak se 3 dhe më shumë se 10 tryeza numërimi. Tryezat e numërimit vendosen në mënyrë të tillë që të jenë të shikueshme nga anëtarët e NjAZ-it dhe nga vëzhguesit, kandidatët ose përfaqësuesit e medias dhe të mundësojnë aplikimin e teknologjisë mbështetëse që KQZ-ja ka vendosur të aplikojë në zgjedhjet përkatëse, si për numërimin, ashtu dhe për vëzhgimin e procesit.
8. Pajisjet e nevojshme logjistike për procesin e votimit e të numërimit të votave sigurohen nga KQZ-ja, në bashkëpunim me organet apo institucionet e tjera qendrore ose vendore.
9. NjAZ-i, jo më vonë se 5 ditë para datës së zgjedhjeve, fton për njohje të VNV-së subjektet zgjedhore dhe anëtarët e NjAV-eve.

## Neni 82

Neni 96 ndryshohet si vijon:

### “Neni 96

#### Infrastruktura zgjedhore në ndërtesa private

1. Kur nuk ka mundësi objektive për të përdorur një ndërtesë publike në respektim të plotë të kushteve dhe kriterëve të këtij ligji për caktimin e vendndodhjes së qendrave të votimit, selive të NjAZ-eve apo VNV-ve, kryetari i bashkisë, gjegjësisht prefekti i qarkut i kërkon KQZ-së miratimin për të caktuar vendndodhjen e qendrave të votimit, selive të NjAZ-eve apo VNV-të në ndërtesa private.
2. Kërkesa paraqitet e shoqëruar me të dhënat për dy objekte alternative, përfshirë të dhënat për pronësinë, planimetrinë ose fotografi të ambientit, një përshkrim për lehtësitë që ofron objekti për zhvillimin normal të zgjedhjeve, si dhe çdo informacion që provon plotësimin e kushteve dhe kriterëve të tjera të këtij ligji lidhur me vendndodhjen e infrastrukturës zgjedhore. Bëjnë përjashtim rastet kur nuk është e mundur gjetja e një objekti alternativ.
3. Caktimi i vendndodhjes së qendrës së votimit, selisë së NjAZ-it apo VNV-së në ndërtesë private bëhet menjëherë publik në faqen e internetit të KQZ-së, me të gjitha të dhënat

identifikuese për vendndodhjen e saj. Njoftimi për vendndodhjen e re afishohet nga bashkia në mjediset publike pranë hyrjes së objektit dhe shoqërohet me tregues të qartë pamorë për vendndodhjen e tij.

### **Neni 83**

Pas nenit 96 shtohet neni 96/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 96/1

Infrastruktura zgjedhore për zgjedhësit me kërkesa të veçanta

1. Zgjedhësit që kanë vështirësi hyrjeje në mjedisin e qendrës së votimit kanë të drejtë të kërkojnë që caktimi i qendrës së votimit dhe organizimi i saj të bëhen në mënyrë të tillë që të garantojnë hyrjen e lirë për këtë kategori zgjedhësish. Në rast se kjo është e pamundur, në përputhje me udhëzimet dhe me shpenzimet e KQZ-së, kryetarët e bashkive caktojnë personel apo pajisje ndihmëse për të garantuar hyrjen e lirë.
2. Zgjedhësit që nuk shikojnë kanë të drejtë të kërkojnë që KQZ-ja të pajisë qendrën e tyre të votimit me mjete të posaçme votimi, të cilat lejojnë zgjedhësit që të lexojnë ose të kuptojnë fletën e votimit dhe të votojnë në mënyrë të pavarur. KQZ-ja, në përputhje me procedurat dhe afatet e shpërndarjes së materialeve zgjedhore, pajis këto qendra votimit me mjetet e posaçme të nevojshme për votim.
3. Kërkesat për pajisjen e posaçme të qendrave të votimit i paraqiten bashkisë brenda periudhës së rishikimit të listave. Kërkesa shoqërohet me dokumentacionin zyrtar që provon llojin dhe kategorinë e paaftësisë. Për zgjedhësit që nuk shikojnë dhe qendrat e votimit ku ata janë regjistruar, Kryetari i Bashkisë njofton KQZ-në.
4. Në rast se zgjedhësit me kërkesa të veçanta nuk kërkojnë pajisjen e qendrave të tyre të votimit me pajisjet dhe mjetet e veçanta për votim, sipas nevojave të tyre, atëherë ata kanë të drejtë të kërkojnë dhe NjAV-i është i detyruar të zbatojë procedurat për votimin e asistuar, për të mundësuar votimin e tyre.
5. Procedura e votimit të asistuar nuk mund të kryhet nga zyrtari zgjedhor. Procedura kryhet nga një zgjedhës i qendrës së votimit që është prezent së bashku me zgjedhësin kërkues dhe që gëzon besimin e këtij të fundit. Një zgjedhës nuk mund të kryejë më shumë se një procedurë votimi të asistuar. Votimi i asistuar kryhet në dhomën e fshehtë.

### **Neni 84**

Neni 99 ndryshohet si vijon:

“Neni 99

Shpërndarja e materialeve zgjedhore

1. Materialet zgjedhore shpërndahen nga KQZ-ja në drejtim të qendrave të votimit, jo më vonë se 3 ditë përpara datës së votimit, të paketuara dhe sistemuara veçmas për çdo qendër votimi. Materiali zgjedhor që përdoret nga NjAZ-i dërgohet NjAZ-it drejtpërdrejt.
2. Në varësi nga mundësitë logjistike, KQZ-ja organizon shpërndarjen e materialit zgjedhor me destinacion drejtpërdrejt qendrat e votimit, ose me destinacion të ndërmjetëm selinë e NjAZ-it, duke shfrytëzuar mjetet e transportit të institucioneve të caktuara publike, ose duke kontraktuar transportin tek të tretë. Në çdo rast, shpërndarja bëhet me dijeninë, nën kujdesin dhe përgjegjësinë për sigurinë nga ana e policisë së shtetit.
3. Materialet zgjedhore duhet të merren në administrim nga administrata përgjegjëse zgjedhore menjëherë pas mbërritjes së tyre në destinacion. Përveç rasteve që përbëjnë forcë madhore, mbërritja në destinacion e materialeve zgjedhore nuk mund të kryhet më vonë se 15 orë përpara orarit për hapjen e votimit.
4. Bashkëpunimi me institucionet e tjera publike për hapat e veçantë të procesit kryhet, sipas marrëveshjeve të posaçme që KQZ-ja lidh me to.
5. Materialet zgjedhore që shpërndahen nga KQZ-ja për qendrat e votimit përcaktohen me vendim të KQZ-së.”

#### Neni 85

Neni 100 ndryshohet si vijon:

“Neni 100

Shpërndarja dhe instalimi i pajisjeve të teknologjisë së informacionit

1. Në rastet kur KQZ-ja vendos përdorimin e pajisjeve të teknologjisë së informacionit në procesin e votimit dhe/ose të numërimit të votave, shpërndarja dhe instalimi i pajisjeve kryhet nga KQZ-ja sipas të njëjtës procedurë që ndiqet për shpërndarjen e materialit zgjedhor.
2. Instalimi i pajisjeve kryhet nga personeli teknik i KQZ-së ose nga operatori privat i kontraktuar për këtë qëllim. Zyrtarët zgjedhorë të NjAV-it, gjegjësisht NjAN-it, kur për administrimin e procedurave të votimit a numërimit nuk është kontraktuar operatori i sistemeve apo pajisjeve të teknologjisë së informacionit, i marrin në dorëzim pajisjet nga personeli teknik, pasi janë instaluar dhe kanë kryer me sukses provën e funksionimit.
3. Në rastet kur për administrimin e procedurave të votimit a numërimit kontraktohet operatori i sistemeve apo pajisjeve të teknologjisë së informacionit, përgjegjësia për instalimin, provën e funksionimit dhe dokumentimin e gadishmërisë është e operatorit dhe e zyrtarëve zgjedhorë të caktuar prej tij.

4. Procedura për dokumentimin e vënies në funksionim të pajisjeve të teknologjisë së informacionit përcaktohet me akt nënligjor të KQZ-së. Procedura duhet të garantojë në çdo rast, detyrimin e NjAV-it, gjegjësisht NjAN-it që, përpara se të deklarojë hapjen e votimit apo të numërimit, të pajisë çdo përfaqësues subjekti dhe vëzhgues të pranishëm në atë moment me kopje printimi nga pajisja, që konfirmon leximin e pajisjes në momentin e hapjes së votimit apo të numërimit.”

#### **Neni 86**

Titulli i kreut I të pjesës së nëntë bëhet: “KUSHTET PËR ADMINISTRIMIN E VOTIMIT”

#### **Neni 87**

Neni 101 ndryshohet si vijon:

“Neni 101

Kushtet për administrimin e votimit

1. Procedurat e hollësishme që administrata zgjedhore ndjek për administrimin e votimit përcaktohen me akt nënligjor të KQZ-së, sipas votimit manual dhe sipas votimit elektronik.
2. Pavarësisht nga mënyra e votimit, rregullat për procedurën e administrimit të tij duhet të garantojnë lirinë dhe fshehtësinë e votimit, transparencën e administrimit dhe pacënueshmërinë e vullnetit të zgjedhësve.
3. Administratës zgjedhore i ndalohet të pengojë, shtyjë, apo zvarrisë votimin për zgjedhësit që paraqiten pranë qendrës së votimit për të ushtruar të drejtën e tyre kushtetuese, brenda orarit zyrtar të votimit, që respektojnë kushtet për procedurat e votimit të përcaktuara në ligj dhe që qartësohen si zgjedhës të qendrës përkatëse të votimit. Asnjë kusht, detyrim apo procedurë ligjore votimi nuk mund të zbatohet me qëllimin që të pengojë, shtyjë apo zvarrisë votimin për këta zgjedhës.
4. Administratës zgjedhore i ndalohet të ushtrojë ndikim, apo të lejojë të tretët të ushtrojnë ndikim, të çfarëdo forme, mbi vullnetin e zgjedhësve për të votuar lirisht, individualisht dhe në fshehtësi të plotë. Zyrtarët zgjedhorë mbajnë përgjegjësi nëse lejojnë votimin familjar ose votimin për të tretë, përveçse kur zbatojnë dispozitat ligjore për votimin e asistuar. Rrethanat kur lejohet votimi i asistuar, rrethi i personave që lejohen të asistojnë, si dhe procedura për dokumentimin e votimit të asistuar është pjesë e rregullave të KQZ-së për administrimin e procedurave të votimit.
5. Administratës zgjedhore i ndalohet të ndërhyjë, modifikojë ose tjetërsojë, apo të lejojë të tretët të ndërhyjnë, modifikojnë ose tjetërsojnë, në çfarëdo formë, rezultatit e votimit apo të numërimit të votave.

6. Administratës zgjedhore i ndalohet të pengojë, ndërpresë ose vështirësojë vëzhgimin, sipas rregullave në fuqi, të procedurave të administrimit të votimit nga përfaqësuesit dhe vëzhguesit e akredituar, apo të refuzojë që përfaqësuesit ose vëzhguesit e akredituar të pajisjen me kopje të dokumentacionit zgjedhor, i cili, sipas ligji, u vëhet atyre në dispozicion.
7. Administrata zgjedhore mban përgjegjësi për garantimin e rregullit dhe rregullshmërisë së votimit, si dhe për sigurinë, dhe pacënueshmërinë e materialit zgjedhor. Në zbatimin e këtij detyrimi, administrata zgjedhore ka të drejtë të kërkojë në çdo kohë mbështetjen e policisë së shtetit. Ndërhyrja e policisë së shtetit bëhet sipas procedurave të miratuara nga KQZ-ja dhe dokumentohet në detaje nga administrata zgjedhore.
8. Pas hyrjes në fuqi të votimit nga jashtë vendit, KQZ-së i ndalohet të pengojë votimin nga jashtë vendit të zgjedhësve që kërkojnë të ushtrojnë të drejtën e tyre kushtetuese, qartësohen si zgjedhës me të drejtë vote nga jashtë vendit dhe respektojnë kushtet për procedurën e votimit të përcaktuara në ligj. Asnjë kusht, detyrim apo procedurë ligjore votimi nga jashtë vendit nuk mund të zbatohet me qëllimin që të pengojë, shtyjë apo zvarrisë votimin për këta zgjedhës.”

#### **Neni 88**

Neni 102 ndryshohet si vijon:

#### **“Neni 102**

#### **Procedura publike e administrimit zgjedhor**

1. Veprimtaria e administratës zgjedhore është veprimtari e rregulluar publike. Procedurat për regjistrimin e kandidatëve dhe të vëzhguesve, për përgatitjen e VNV-ve, për hapjen, zhvillimin dhe mbylljen e votimit, për përgatitjen e numërimit, hapjen, zhvillimin dhe mbylljen e tij ndiqen nga përfaqësuesit subjekteve zgjedhore dhe vëzhguesit e akredituar.
2. Përfaqësuesit dhe vëzhguesit e akredituar janë të detyruar të respektojnë rregullat e KQZ-së për rendin në mjediset ku vëzhgojnë, si dhe urdhërat e NjAZ-it ose NjAV-it kompetent për rivendosjen e rendit brenda mjedisit.
3. Në qendrën e votimit mund të qëndrojnë vetëm:
  - a) zyrtarët zgjedhorë të NjAV-it;
  - b) zgjedhësit që janë duke kryer procedurat e votimit deri në përfundim të tyre; dhe
  - c) përfaqësuesit e subjekteve dhe vëzhguesit e akredituar shqiptarë dhe të huaj.
4. Kur bëhet numërimi manual i votave, gjatë procesit në VNV janë të pranishëm vetëm zyrtarët zgjedhorë të NjAZ-it dhe NjAN-it që janë në ushtrim të detyrave, kandidatët, vëzhguesit e subjekteve zgjedhore, vëzhgues të tjerë të akredituar, përfaqësuesit e



akredituar të medias, si dhe personeli teknik dhe administrativ i KQZ-së i autorizuar për të asistuar procesin.

5. Prezenca e personave të tjerë, jashtë parashikimeve të këtij neni, në mjediset ku kryhet administrimi zgjedhor është shkak për pezullimin e procesit dhe për të kërkuar ndërhyrjen e policisë së shtetit brenda mjediseve për të rivendosur rendin. Ndërhyrja e policisë së shtetit bëhet sipas procedurave të miratuara nga KQZ-ja dhe dokumentohet në detaje nga administrata zgjedhore.

### **Neni 89**

Neni 103 ndryshohet si vijon:

“Neni 103

Paanshmëria e administrimit

1. Zyrtarët zgjedhorë janë të paanshëm në ushtrimin e detyrës. Ata nuk mund të shprehin, as shfaqin parapëlqim për asnjë nga subjektet apo kandidatët garues në zgjedhje as gjatë ushtrimit të detyrës, as jashtë saj, nga momenti i emërimit, deri në momentin e lirimit të tyre nga detyra.
2. Zyrtarët zgjedhorë votojnë individualisht dhe në fshehtësi. Ata nuk mund të tregojnë as komentojnë votën e tyre me të tretë, sa kohë janë në ushtrim të detyrës.
3. Zyrtarët zgjedhorë nuk mund të ftojnë as t'u kërkojnë zgjedhësve të votojnë për një subjekt apo kandidat të caktuar. Kur në ushtrim të funksioneve të tyre ata informojnë zgjedhësit për procedurat e votimit që duhet të ndjekin, ata nuk mund të ilustrojnë udhëzimet që japin për votimin me asnjë subjekt apo kandidat real.
4. Zyrtarët zgjedhorë të qendrës së votimit janë përgjegjës për ruajtjen e heshtjes zgjedhore në mjediset e qendrës së votimit. Ata janë të detyruar për të ndërhyrë menjëherë dhe të rivendosin rregullin, nëse në mjediset e qendrës së votimit ushtrohet propagandë zgjedhore nga personat e pranishëm në qendrën e votimit.
5. Në mjediset e brendshme dhe të jashtme të qendrës së votimit, selive të NjAZ-eve dhe në VNV-të nuk lejohet asnjë material me përmbajtje zgjedhore, përveç materialeve udhëzuese të KQZ-së. Zyrtarët zgjedhorë të qendrës së votimit janë përgjegjës për çlirimin e mjediseve të jashtme të qendrës së votimit nga materialet propagandistike, përpara fillimit të procedurave të votimit.”

### **Neni 90**

Ttulli i kreut II të pjesës së nëntë vendoset pas nenit 104 dhe ndryshohet si vijon:  
“ADMINISTRIMI I VOTIMIT DHE REZULTATI”

## Neni 91

Neni 104 ndryshohet si vijon:

“Neni 104

Siguria dhe pacënueshmëria

1. Siguria e jashtme e infrastrukturës zgjedhore mbrohet nga policia e shtetit, në përputhje me rregullat e vendosura nga KQZ-ja. Asnjë person i armatosur nuk lejohet të qëndrojë në mjediset e qendrës së votimit. Përfshihen nga ky rregull punonjësit e Policisë së Shtetit, kur thirren në përputhje me këtë ligj për të rivendosur rregullin, si dhe punonjësit e policisë së burgjeve brenda territorit të burgut ose vendit të paraburgimit, ku është ngritur qendra e posaçme e votimit.
2. Siguria e materialit zgjedhor, kutive të votimit dhe e fletëve të votimit është përgjegjësi e administratës zgjedhore. Përdorimi i tyre bëhet duke zbatuar masat që garantojnë pacënueshmërinë e kutive, gjegjësisht të pajisjeve të teknologjisë së informacionit në rastin e votimit elektronik, si dhe autenticitetin e fletëve të votimit, sikurse përcaktojnë rregullat e miratuara nga KQZ-ja për votimin dhe administrimin e materialit zgjedhor, si dhe duke vëzhguar sjelljen e votuesve gjatë kryerjes së votimit.
3. Zyrtarët zgjedhorë janë përgjegjës për moslejimin e prishjes apo dëmtimit nga ana e personave të pranishëm në qendrën e votimit të vulave të sigurisë ose dëmtimit të kutive të votimit, gjegjësisht pajisjeve të teknologjisë së informacionit në përdorim. Në rast se ndodhin incidente të tilla, zyrtarët zgjedhorë duhet të kërkojnë ndërhyrjen menjëherë të organeve të rendit publik, të regjistrojnë incidentin në librat e tyre të protokollit, të sigurojnë të dhënat identifikuese të autorit apo autorëve, dhe të personave të pranishëm në momentin e incidentit, si dhe të njoftojnë NjAZ-in.
4. Zyrtarët e procedurave të votimit janë përgjegjës për administrimin sipas rregullave për procedurat e votimit të vulave që autentifikojnë fletët e votimit. Fletët e votimit të autentifikuara nuk mund t'u dorëzohen zgjedhësve për votim, pa përfunduar me sukses procedurën e qartësimit të tyre. Asnjë zgjedhës nuk mund të marrë në dorëzim fletë votimi në emër dhe për llogari të zgjedhësve të tjerë, përveç rasteve të votimit të asistuar.
5. Zyrtarët mbikëqyrës janë përgjegjës për moslejimin e tjetërsimit nga votuesit të fletëve të votimit të autentifikuara. Fletët e votimit të autentifikuara nuk mund të dalin jashtë qendrës së votimit. Zyrtarët mbikëqyrës duhet të kujdesen që zgjedhësi t'i hedhë ato në kuti. Në rast se ndodhin incidente të tilla, zyrtarët zgjedhorë duhet të kërkojnë ndërhyrjen menjëherë të organeve të rendit publik, të regjistrojnë incidentin në librat e tyre të protokollit, të sigurojnë të dhënat identifikuese të autorit apo autorëve, dhe të personave të pranishëm në momentin e incidentit, si dhe të njoftojnë NjAZ-in.
6. Zyrtarët mbikëqyrës janë përgjegjës për moslejimin e fotografimit nga votuesit të fletëve të votimit të plotësuar. Në rast se ndodhin incidente të tilla, zyrtarët zgjedhorë duhet të

kërkojnë ndërhyrjen menjëherë të organeve të rendit publik, të regjistrojnë incidentin në librat e tyre të protokollit, të sigurojnë të dhënat identifikuese të autorit apo autorëve, dhe të personave të pranishëm në momentin e incidentit, si dhe të njoftojnë NjAZ-in.

7. Transporti i kutive të votimit dhe të materialeve zgjedhore pas përfundimit të procesit bëhet vetëm pasi të jetë mbyllur kutia me vula sigurie. Përgjegjës për sigurinë në transport janë organet e ruajtjes së rendit, në përputhje me rregullat e vendosura nga KQZ-ja.
8. Kutitë mbyllen me vula sigurie edhe pas çdo procedure ligjore verifikimi apo numërimi, deri në momentin e asgjesimit përfundimtar të fletëve të votimit dhe materialit zgjedhor.
9. Kutitë që kanë vulat e sigurisë të dëmtuara, ose kodet e tyre nuk përputhen me kodet e mbylljes, ose mbyllja e sigurtë e kutisë është cënuar në çfarëdolloj forme, deklarohen nga administrata zgjedhore "të parregullta" dhe përjashtohen nga veprimet e mëtejshme proceduriale. Kutitë e parregullta administrohen më tej vetëm për qëllimet e hetimit administrativ ose penal.

## **Neni 92**

Neni 105 ndryshohet si vijon:

“Neni 105

Dokumentimi

1. Të gjitha procedurat e administrimit të zgjedhjeve dokumentohen nga zyrtarët zgjedhorë në librat përkatës. Dokumentimi është përgjegjësi e zyrtarit zgjedhor që ushtron funksionet e sekretarit. Dokumentimi i shërben verifikimit të mëpasshëm të veprimtarisë së administratës zgjedhore, të incidenteve që mund të kenë ndodhur gjatë procesit, si dhe të masave për kapërcimin e tyre. Dokumentimi formon provë për procesin ankimor, disiplinor dhe atë penal.
2. Rregulloret e KQZ-së për procedurat duhet të vendosin rregulla të qarta për garantimin e të drejtës së përfaqësuesve të subjekteve zgjedhore, të vëzhguesve apo palëve të treta që legjitimohen për t'u pajisur me kopje ose, sipas rastit, për të këqyruar dokumentacionin zgjedhor.
3. Kopjet e dokumentacionit që përmban rezultatin e votimit u vihen në dispozicion menjëherë përfaqësuesve të subjekteve zgjedhore dhe vëzhguesve të akredituar të pranishëm.”

## **Neni 93**

Neni 106 ndryshohet si vijon:

“Neni 106

Vlerësimi i fletëve të votimit dhe i votave

1. Votat janë të vlefshme ose të pavlefshme, në varësi të gjendjes së fletëve të votimit dhe llojit të shënimeve që janë bërë mbi të.
2. Votat janë të vlefshme kur fletët e votimit janë të rregullta dhe është votuar qartësisht vetëm për njërin nga subjektet zgjedhore apo partinë politike pjesëtare të koalicionit në fletën përkatëse të votimit.
3. Votat janë të pavlefshme kur:
  - a) fleta e votimit nuk ka të njëjtën madhësi, ngjyrë ose formë me fletën e votimit të miratuar nga KQZ-ja;
  - b) fletës së votimit i mungon vula autentifikuese;
  - c) në fletën e votimit janë bërë shënime apo shenja që bëjnë të pamundur vlerësimin e votës;
  - ç) në fletën e votimit janë bërë shënime në favor ose në disfavor të subjekteve të caktuara zgjedhore;
  - d) është votuar për më shumë se një nga subjektet zgjedhore në fletën e votimit;
  - dh) nuk është votuar për asnjë nga subjektet zgjedhore në fletën e votimit;
  - e) nuk është e qartë se për kë është votuar; ose
  - ë) zgjedhësi ka votuar për një person apo subjekt që nuk është në fletën e votimit.
4. Vlerësimi i votave synon të identifikojë, sa të jetë e mundur, qëllimin e zgjedhësit. Në zbatim të këtij neni, KQZ-ja përgatit udhëzues të veçantë për të lehtësuar punën dhe unifikuar praktikën e vlerësimit të fletëve nga ana e komisioneve dhe personave të ngarkuar nga ky ligj për numërimin dhe vlerësimin e votave.
5. Në rastet e votimit elektronik, sistemet ose pajisjet e teknologjisë së informacionit formatohen në mënyrë të tillë që të lehtësojnë shprehjen qartësisht të vullnetit nga ana e zgjedhësit, të pengojnë nxjerrjen e pavlefshme të votës, si dhe të lexojnë saktësisht votën. Sistemet ose pajisjet e teknologjisë së informacionit që përdoren për votim i nënshtrohen testimit parazgjedhor dhe verifikimit paszgjedhor, sipas rregullave të përcaktuara nga KQZ-ja.
6. Në rastet e numërimit manual të votave, kur kontestohet vlerësimi i bërë nga zyrtari zgjedhor i numërimit, votat e kontestuara rivlerësohen nga NJAZ-i dhe përfshihen në rezultat. Votat e rivlerësuara nga NJAZ-i shenjohen, me qëllim që të bëjnë të mundur rivlerësimin dhe, eventualisht korrigjimin e rezultatit përgjatë procedurës ankimore.
7. Procedurat e hollësishme që administrata zgjedhore ndjek për administrimin e numërimit përcaktohen me akt nënligjor të KQZ-së, sipas numërimit manual dhe sipas numërimit elektronik.”

## Neni 94

Neni 107 ndryshohet si vijon:

“Neni 107

Nxjerrja e rezultatit të zgjedhjeve nga administrata zgjedhore

1. Në rastet e votimit elektronik, rezultati i zgjedhjeve në nivelin e qendrës së votimit nxirret nga sistemi ose pajisjet elektronike të përdorura për votimin, menjëherë pas mbylljes së procesit të votimit, si printim nga pajisja.
2. Rezultati i zgjedhjeve shpallet publikisht nga NjAV-i dhe çdo përfaqësuesi subjekt dhe vëzhgues i pranishëm në atë moment në qendrën e votimit ka të drejtë të marrë kopje printimi nga pajisja, të zyrtarizuara nga NjAV-i. Rezultati i zgjedhjeve hidhet në tabelën e rezultatit të votimit për qendrën e votimit dhe i dërgohet NjAZ-it për tabulim.
3. Në rastin kur bëhet numërimi manual, ose kur sistemet dhe pajisjet e teknologjisë së informacionit që përdoren në zgjedhje kryejnë vetëm numërimin elektronik, vlerësimi dhe numërimi i votave kryhet nga NjAN-i. Vlerësimi dhe numërimi nga NjAN-i kryhet si proces i pandërprerë.
4. Rezultati i zgjedhjeve në nivel ZAZ-je nxirret nga NjAZ-i në përfundim të procesit të numërimit për të gjitha qendrat e votimit brenda territorit të ZAZ-së. Rezultati i zgjedhjeve del si shumatore e rezultatit të qendrave të votimit dhe përfshihet në tabelën përmbledhëse e rezultatit të zgjedhjeve për ZAZ-në.
5. Tabulimi i rezultatit në nivel ZAZ-je është proces i pandërprerë. NjAZ-i nuk mund të vonojë për asnjë shkak ose rrethanë tabulimin e rezultatit të qendrave të votimit, të përjashtojë rezultatin e qendrave të veçanta nga tabela përmbledhëse, ose të modifikojë rezultatin zyrtar të nxjerrë nga NjAN-i ose nga pajisjet e teknologjisë së informacionit që kanë kryer numërimin.
6. NjAZ-it nuk i lejohe të korigjojë rezultatin e votimit për një qendër votimi, në rast se konstaton mospërputhje midis shifrave, pa urdhëruar rinumërimin e votave dhe pa marrë një tabelë rezultati të re nga NjAN-i. Korigjimi shënohet në librat përkatës të protokollit dhe shërben si provë për hetimin e mëtejshëm administrativ.
7. Tabela përmbledhëse e rezultatit shpallet publikisht menjëherë pas përpilimit dhe kopje të saj u vihen në dispozicion menjëherë përfaqësuesve të subjekteve zgjedhore dhe vëzhguesve të akredituar të pranishëm.
8. Në rast të zgjedhjeve vendore, kur territori i bashkisë nuk mbulohet nga një NjAZ i vetëm, çdo NjAZ përpilon Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve për ZAZ-në e vet. Kopja origjinale e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve të ZAZ-së dhe Tabelat e Rezultateve për çdo qendër votimi i dërgohen KQZ-së për të nxjerrë rezultatin e zonës zgjedhore.”

## Neni 95

Neni 108 ndryshohet si vijon:

“Neni 108

Nxjerrja e rezultateve nga KQZ-ja

1. KQZ-ja verifikon dhe nxjerr rezultatet e votimit për zonën zgjedhore për Kuvendin apo për njësinë e qeverisjes vendore, territori i së cilës është i ndarë në dy apo më shumë ZAZ, në bazë të tabelave të rezultateve të nxjerra për të gjitha ZAZ-të që përfshihen në zonën zgjedhore përkatëse. Për këtë, KQZ-ja plotëson Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore dhe e miraton atë me vendim jo më vonë se 48 orë nga mbërritja e të gjitha tabelave të zonës zgjedhore.
2. Përpara plotësimit të Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit për Zonën Zgjedhore, sipas pikës 1 të këtij neni, KQZ-ja kontrollon kryesisht ose me kërkesë të palëve përpara marrjes së vendimit, sipas këtij neni, nëse tabelat e rezultateve të ZAZ-ve të zonës përkatëse përfshijnë të gjitha tabelat e qendrave të votimit të asaj zone.
3. Kur KQZ-ja konstaton se tabela e rezultateve të një ZAZ-je nuk përfshin tabelat e të gjitha qendrave të votimit të asaj ZAZ-je, kutitë e së cilës janë pranuar të rregullta, urdhëron NjAZ-in që të plotësojë menjëherë tabelën dhe ta ridërgojë në KQZ brenda 24 orëve. Në rast mosplotësimi brenda këtij afati, tabela plotësohet nga KQZ-ja.
4. Në rast se votat e një kutie të pranuar si të rregullt nuk janë numëruar, KQZ-ja urdhëron numërimin fillestar të votave të panumëruara të qendrës së votimit që nuk është përfshirë në tabelën e rezultateve. Afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni fillon pas plotësimit të secilës tabelë rezultati ZAZ-je, sipas kësaj pike.
5. Në çdo rast Tabela Përmbledhëse e Rezultatit për Zonën Zgjedhore, sipas këtij neni, nuk mund të miratohet nga Komisioneri, pa numëruar të gjitha kutitë e pranuar të rregullta, sipas këtij Ligji, në të kundërt vendimi i miratimit të Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore, sipas këtij neni, është i pavlefshëm.
6. Kur gjatë hartimit të tabelës KQZ-ja, kryesisht ose me kërkesë të palëve, vëren mospërputhje të shifrave të votave për subjektet të tabelës së rezultatit të ZAZ-së me tabelat e rezultateve të qendrave të votimit, merr vendim për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore me shifrat e korrigjuara, duke u bazuar në origjinalet e tabelave të qendrave të votimit. Një kopje e vendimit për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore u jepet të gjitha subjekteve zgjedhore që kanë marrë pjesë në zgjedhjet e zonës zgjedhore përkatëse.
7. Në vendimin për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore, Komisioneri është i detyruar të shprehet edhe për kërkesat e depozituara për lëndën, duke bërë arsyetimin e detajuar ligjor për pranimin ose refuzimin e tyre.

8. Vendimi i Komisionerit për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore, sipas këtij neni, mund të ankimohet në KAS, sipas procedurave të parashikuara në këtë ligj për ankimimin e vendimeve të administratës zgjedhore.
9. Vendimi i NjAZ-it për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zgjedhjeve të ZAZ-së, çdo vendim i NjAZ-it, i marrë gjatë procedurës së marrjes në dorëzim të materialeve dhe dokumentacionit zgjedhor nga NjAV-et, si dhe gjatë numërimit dhe nxjerrjes së rezultatit të votimit, janë vendime të ndërmjetme dhe ankimohen në KAS së bashku me ankimin kundër vendimit të Komisionerit për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore, të marrë sipas pikës 1 të këtij neni.”

#### **Neni 96**

Nenet 109 dhe 110 shfuqizohen.

#### **Neni 97**

Titulli i kreut III të pjesës së nëntë ndryshohet si vijon: “TRANSPARENCA E VEPRIMTARISË SË KQZ-SË”

#### **Neni 98**

Neni 112 ndryshohet si vijon:

“Neni 112

Publiciteti i mbledhjeve dhe seancave

1. Mbledhjet e Rregullatorit dhe seancat e KAS-it janë kurdoherë publike.
2. Në mbledhje dhe seanca ftohen të marrin pjesë përfaqësuesit e partive parlamentare në KQZ, kurse përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore marrin pjesë pas regjistrimit, i cili mbyllet në orarin për fillimin e mbledhjes ose të seancës.”

#### **Neni 99**

Neni 113 ndryshohet si vijon:

“Neni 113

Këqyrja e mëpasme e fletëve të votimit dhe e materialit zgjedhor

1. Këqyrja e mëpasme e fletëve të votimit dhe e materialit zgjedhor bëhet për të verifikuar rregullsinë dhe saktësinë e veprimtarisë së administratës zgjedhore përgjatë administrimit të procesit dhe vlerësimit e numërimit të votave.

2. Këqyrja lejohet të bëhet vetëm pasi të jetë shpallur rezultati përfundimtar, të jenë përmbyllur procedurat ankimore dhe zgjedhjet të kenë përfunduar. Ky rregull nuk vlen për këqyrjen që bëhet në kuadër të procesit ankimor, si mjet për sigurimin e provës.
3. Këqyrja bëhet nga KQZ-ja, me përzgjedhje rastësore, ose me kërkesë të palëve të interesuara, me përcaktim. Pavarësisht së kush ka marrë nismën për këqyrjen, procesi realizohet nga personeli i KQZ-së në seancë publike, në të cilën ftohen të marrin pjesë kërkuesi dhe përfaqësuesit e partive parlamentare në KQZ. Procesi videoregjistrohet dhe videoregjistrimi ruhet në arkivin e KQZ-së.
4. Kur këqyrja bëhet me kërkesë të palëve të interesuara, ato mbulojnë shpenzimet administrative të procesit. Nuk lejohet kryerja e këqyrjes së fletëve të votimit ose të materialit zgjedhor që është këqyrur më parë, kryesisht ose me kërkesë të palëve të tjera të interesuara. Në rast se një palë e interesuar kërkon këqyrjen e fletëve të votimit ose të materialit zgjedhor që është këqyrur më parë, kërkesa refuzohet duke i ofruar palës së interesuar njëkohësisht videoregjistrimin për këqyrjen e mëparshme.
5. Rregullatori përcakton me akt normativ tarifat e shërbimit administrativ të këqyrjes dhe çmimin e videoregjistrimit.
6. Procedura që zbatohet gjatë këqyrjes është e ngjashme me procedurën që ndjek administrata zgjedhore përgjatë veprimtarisë në zgjedhje.
7. Në rast se nga këqyrja e fletëve të votimit ose e materialit zgjedhor konstatohen parregullsi ose pasaktësi që bëjnë me faj zyrtarët zgjedhorë përkatës, KQZ-ja është e detyruar të nisë procedimin disiplinor, gjegjësisht të bëjë kallëzimin penal për zyrtarët përgjegjës.
8. Rezultatet e verifikimit paszgjedhor nuk mund të jenë bazë në vetvete, dhe as nuk mund të shërbejnë qoftë edhe në mënyrë të tërthortë, për ankimimin, kundërshtimin, mosnjohjen e rezultatit të zgjedhjeve, apo për anulimin, heqjen, shfuqizimin apo ndërprerjen e mandatit të fituar nga zgjedhjet, për cilindo subjekt, person të interesuar apo institucion që kërkon të ndërmarrë hapa ligjore në këtë drejtim.”

## **Neni 100**

Neni 114 ndryshohet si vijon:

“Neni 114

Raportimi për hetimin penal

1. KQZ-ja i kërkon informacion të rregullt organeve të policisë dhe të prokurorisë për hetimin e veprave penale në fushën e zgjedhjeve. Informacioni kërkohet me të dhënat për çështjet penale, personat nën hetim, kohëzgjatjen e hetimit dhe përfundimin e tij, të dhënat për kërkesat e prokurorisë për gjykim, kohëzgjatjen e gjykimit dhe përfundimin e tij, të dhënat



për ankimimin e vendimeve gjyqësore, shkakun e ankimimit, si dhe të dhënat për faktin nëse çështjet janë gjykuar në apel ose në Gjykatën e Lartë dhe rezultatin e këtij gjykimi. Pjesë e informacionit duhet të jetë dhe informacioni për ekzekutimin e dënimeve.

2. KQZ-ja është e detyruar që të mbajë, përditësojë dhe publikojë statistikë të rregullt për hetimet penale, me të gjithë informacionin e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, si dhe të informojë Kuvendin gjatë raportimeve periodike ose vjetore, si zë më vete, për gjendjen e hetimeve penale për çështjet zgjedhore.”

### **Neni 101**

Titulli i kreut IV të pjesës së nëntë zhvendoset pas nenit 115 dhe ndryshohet si vijon: “HETIMI ADMINISTRATIV”

### **Neni 102**

Neni 115 ndryshohet si vijon:

“Neni 115

Raportimi për masat disiplinore dhe administrative

1. KQZ-ja informon Departamentin e Administratës Publike (DAP) për zyrtarët zgjedhorë, të cilëve u hiqet dëshmia e zyrtarit zgjedhor, duke i dërguar kopje zyrtare të aktit që ka hequr dëshminë, si dhe i kërkon DAP-it informacion për zbatimin e masës së largimit nga shërbimi civil për nëpunësit civilë, të cilëve u është hequr dëshmia.
2. KQZ-ja është e detyruar që të mbajë, përditësojë dhe publikojë statistikë të rregullt për zyrtarët zgjedhorë, të cilëve u është hequr dëshmia e zyrtarit zgjedhor, me të dhënat për identitetin e zyrtarit zgjedhor, aktin që ka hequr dëshminë, datën e heqjes së dëshmisë, të dhënat për ekzekutimin e masës së largimit nga puna, si dhe të dhëna të detajuara për vendimet eventuale gjyqësore të ankimimit ndaj masës, dhe efektet e tyre.
3. KQZ-ja është e detyruar që të mbajë, përditësojë dhe publikojë statistikë të rregullt për procedimet administrative të KAS-it, me të dhënat për subjektet e masave administrative, aktin që ka vendosur masën e dënimit, të dhënat për ekzekutimin e masës, si dhe të dhëna të detajuara për vendimet eventuale gjyqësore të ankimimit ndaj saj, dhe efektet e tyre.
4. KQZ-ja është e detyruar të informojë Kuvendin për zbatimin e masave disiplinore dhe administrative, gjatë raportimeve periodike ose vjetore.”

### **Neni 103**

Neni 116 ndryshohet si vijon:

“Neni 116

E drejta për të vënë në lëvizje KQZ-në

1. KQZ-ja vihet në lëvizje kryesisht, me kërkesë të subjekteve zgjedhore, në zbatim të të drejtave që u njeh ky ligj, si dhe me kërkesë të palëve të treta, në mbrojtje të interesave të tyre të ligjshme dhe për çështje që bëjnë pjesë në rrethin e kompetencave të KQZ-së.
2. Kërkesat ose ankesat e subjekteve zgjedhore trajtohen sipas procedurës së përcaktuar nga ky ligj dhe nga aktet nënligjore të dala në zbatim të tij. Kërkesat, ankesat, informacionet, propozimet apo denoncimet e palëve të treta trajtohen sipas procedurës së përcaktuar në Kodin e Procedurave Administrative dhe sipas afateve që përcakton KQZ me akt nënligjor.
3. Kur kërkesat, ankesat, informacionet, propozimet apo denoncimet e palëve të treta kanë lidhje me hetime administrative që kryhen në bazë të këtij ligji për veprimtarinë në zgjedhje të subjekteve zgjedhore, atëherë ato bëhen pjesë e hetimit administrativ ndaj subjektit zgjedhor.”

#### **Neni 104**

Neni 117 ndryshohet si vijon:

“Neni 117

Kompetenca për hetimin administrativ

1. Si rregull, hetimi administrativ kryhet nga administrata e KQZ-së, përveç rasteve kur, për hetimin e çështjeve të veçanta, legjislacioni zgjedhor kërkon emërimin e ekspertëve jashtë administratës.
2. Hetimi administrativ i kryer nga ekspertët e jashtëm merr vlerë juridike, vetëm pasi miratohet nga KQZ-ja, sipas rregullave procedurale në fuqi.”

#### **Neni 105**

Neni 16/1 dhe nenet 118 deri 123 shfuqizohen.

#### **Neni 106**

Titulli i pjesës së dhjetë bëhet: “ANKIMI ADMINISTRATIV”

#### **Neni 107**

Neni 124 ndryshohet si vijon:

“Neni 124

Ankimi administrativ i subjekteve zgjedhore

1. Çdo parti politike, pjesëtare ose jo e një koalicioni, dhe kandidati i propozuar nga zgjedhësit kanë të drejtë të ankohen në KAS kundër vendimeve të NjAZ-it ose vendimeve të Rregullatorit, që cenojnë interesat e tyre të ligjshëm, brenda 3 ditëve nga data e shpalljes së vendimit.
2. Të drejtën e ankimit, sipas pikës 1 të këtij neni, e kanë edhe individët ose partitë politike, të cilëve u është refuzuar kërkesa për regjistrim si subjekt zgjedhor.
3. Rezultati i zgjedhjeve ankimohet në KAS jo më vonë se 5 ditë nga shpallja e vendimit për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore. Ankimi ndaj vendimit mund të përmbajë ndryshimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore ose/dhe pavlefshmërinë e rezultatit në një apo disa qendra votimi. Në çdo rast, ankimi për pavlefshmëri dhe ankimi për ndryshimin e tabelës së rezultatit paraqitet në të njëjtën kërkesë ankimore. Në kërkesë përcaktohen qendrat e votimit, për të cilat kërkohet ndryshimi i rezultatit apo pavlefshmëria. Në shqyrtimin e kërkesave ankimore të paraqitura, KAS-i shqyrton të gjithë problematikën e tyre, përfshirë edhe pavlefshmërinë e zgjedhjeve në qendra të caktuara votimi, pa u kufizuar në objektin e kërkimit të kërkesës ankimore të paraqitur nga subjekti zgjedhor.”

#### **Neni 108**

Neni 125 ndryshohet si vijon:

#### **“Neni 125**

**Ankimi administrativ i palëve të treta**

1. Organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, si dhe organizatat ndërkombëtare të specializuara ose të angazhuara në mirëqeverisjen dhe demokratizimin, përfaqësuesit e shteteve të huaja dhe të medias, kanë të drejtë të ankohen në KAS kundër vendimeve që refuzojnë regjistrimin e vëzhguesve, brenda 3 ditëve nga data e shpalljes së vendimit.
2. Kundër akteve normative të Rregullatorit lejohet ankim në rrugë administrative në KAS nga të gjitha palët që demonstrojnë një interes të ligjshëm për çështjen objekt i ankimit, pavarësisht nëse janë njëkohësisht subjekte zgjedhore, apo parti parlamentare. Në periudhën nga dalja e dekretit të Presidentit të Republikës për zhvillimin e zgjedhjeve, deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar, ankimi paraqitet brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit. Për periudhën tjetër, ankimi paraqitet brenda 30 ditëve nga dalja e vendimit.”

#### **Neni 109**

Neni 126 ndryshohet si vijon:

#### **“Neni 126**

**Palët në shqyrtimin e ankimit administrativ**

1. Në shqyrtimin e ankimit nga KAS-i kanë të drejtë të marrin pjesë:
  - a) ankuesi;
  - b) komisioneri, ose të ngarkuarit e tij nga administrata e KQZ-së;
  - c) pala e interesuar.
2. Palë e interesuar është, në varësi nga objekti i ankimit, subjekt zgjedhor ose palë e tretë, të drejtat dhe interesat e ligjshëm të të cilit, qofshin këta individualë ose të përbashkët, preken ose kanë të ngjarë të preken nga vendimi që mund të jepet në përfundim të procedurës administrative.
3. Pala e interesuar depoziton kërkesën e saj për të marrë pjesë në shqyrtimin e një ankimi, jo më vonë se ora e caktuar për zhvillimin e seancës. Depozitimi jashtë këtij afati passjell mospranimin e kërkesës.
4. Pranimi i palës së interesuar në procedurën administrative bëhet me vendim të KAS-it në fillim të seancës përkatëse dhe pas verifikimit të pjesëmarrjes së palëve të tjera.
5. Palët kanë të drejtë të përfaqësohen gjatë procedurës administrative nga përfaqësues të autorizuar prej tyre ose me deklaram në seancë. Subjektet zgjedhore të përfaqësuara në KQZ, si rregull, përfaqësohen nga përfaqësuesit e akredituar të tyre në KQZ.”

#### **Neni 110**

Neni 127 ndryshohet si vijon:

“Neni 127

Detyrimi i organeve të tjera për të vënë në dispozicion prova

1. KQZ-ja u kërkon organeve të administratës publike të vënë në dispozicion informacione, dokumente ose çdo provë tjetër që kërkohet ose çmohet e nevojshme për hetimin administrativ.
2. Organet e administratës publike janë të detyruara të vënë në dispozicion provat, sipas pikës 1 të këtij neni, me marrjen e kërkesës së KQZ-së dhe brenda afatit të përcaktuar në të.
3. Në qoftë se organi i administratës publike, pa shkaqe të ligjshme, refuzon plotësimin e kërkesës ose nuk e plotëson atë në afat, KQZ-ja, në përputhje me **nenin 172** të këtij ligji, gjobit ose, sipas rastit, kallëzon për ndjekje penale personat përgjegjës.”

#### **Neni 111**

Neni 129 ndryshohet si vijon:

“Neni 129

## Lloji i vendimeve të KAS-it pas shqyrtimit të ankimeve dhe afatet

1. Në përfundim të shqyrtimit të ankimit KAS-i vendos sipas rastit:
  - a) pushimin e shqyrtimit;
  - b) lënien në fuqi të vendimit të NjAZ-it ose të Rregullatorit;
  - c) ndryshimin e vendimit të NjAZ-it ose të Rregullatorit;
  - ç) shpalljen e zgjedhjeve të pavlefshme në një ose disa qendra votimi të zonës zgjedhore ose në të gjithë njësinë zgjedhore;
  - d) lënien në fuqi ose ndryshimin e vendimit për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit të zgjedhjeve.
2. KAS-i merr vendim, sipas njërit nga rastet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, pavarësisht nga ajo çfarë ankuesi ka kërkuar në ankimin e tij.
3. KAS-i merr vendim përfundimtar, në lidhje me ankimin ndaj vendimit për miratimin e tabelës së rezultateve të zgjedhjeve, jo më vonë se 5 ditë nga data kur është regjistruar ankimi përkatës. Në çdo rast tjetër, KAS-i merr vendim jo më vonë se dy ditë nga paraqitja e ankimit.
4. Në rastin e bashkimit të kërkesave ankimore, afatet llogariten nga data e regjistrimit të kërkesës së fundit ankimore.”

### Neni 112

Neni 130 ndryshohet si vijon:

### “Neni 130

#### Llogaritja e afateve

1. Afatet që në Pjesët X dhe XI të këtij ligji janë përcaktuar me orë llogariten duke përjashtuar orën në të cilën lind e drejta e ankimit ose detyrimi administrativ. Në të gjitha rastet kur afatet në këtë ligj llogariten me orë, organi administrativ i ngarkuar nga ky ligj është i detyruar të shënojë në aktin administrativ orën e shpalljes së aktit. Në rast të kundërt, afati llogaritet duke filluar nga ora 08.00 e ditës pasardhëse.
2. Në rast se plotësimi i afateve, sipas pikës 1 të këtij neni, bie jashtë orarit zyrtar të punës, atëherë ecja e afatit pezullohet në orën e mbarimit të orarit zyrtar dhe rifillon në orën e fillimit të orarit zyrtar në ditën pasardhëse.
3. Afatet që në këtë pjesë janë përcaktuar me ditë llogariten duke përjashtuar ditën në të cilën lind e drejta e ankimit ose detyrimi administrativ.
4. Në rast se plotësimi i afateve bie në ditët e pushimeve ose festave zyrtare, afati fillon në ditën më të parë pasardhëse të punës.

5. Për afatet e ankimit, sipas kësaj pjese, nuk mund të ketë rivendosje në afat.
6. Për efekt të këtij neni, orar zyrtar i punës llogaritet koha nga ora 8:00 deri në orën 16:00 dhe ditë pushimi janë dita e shtunë dhe dita e diel.”

#### **Neni 113**

Nenet 131 deri 144 shfuqizohen.

#### **Neni 114**

Neni 145 ndryshohet si vijon:

“Neni 145

E drejta e ankimit në gjykatë

1. Subjektet zgjedhore kanë të drejtë të bëjnë ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë kundër vendimeve të KQZ-së, kur ato cenojnë interesat e tyre të ligjshëm brenda afatit të përcaktuar në nenin 146 të këtij Kodi. Të drejtën e ankimit, sipas këtij neni, e kanë edhe individët ose partitë politike, të cilëve u është refuzuar kërkesa për regjistrim si subjekt zgjedhor.
2. Subjektet zgjedhore kanë të drejtë të bëjnë ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë për mosmarrje të vendimit brenda afatit ligjor nga KQZ-ja. Në këtë rast Gjykata nuk e gjykon çështjen në themel dhe, kur pranon kërkesën, vendos detyrimin e KQZ-së për të marrë vendim duke i caktuar një afat për marrjen e tij. Përjashtim nga ky rregull bëjnë vendimet e KQZ-së për rrëzimin e kërkesës ankimore në lidhje me vendimet të marra në përputhje me shkronjat “a”, “b” “c” dhe “ç” të nenit 24 të këtij Kodi.
3. Të drejtën e ankimit, sipas këtij neni, e kanë edhe subjektet e përmendura në nenin 6 të këtij Kodi, të cilëve u është refuzuar kërkesa për akreditimin e vëzhguesve. Në rastet kur akreditimi i vëzhguesve i delegohet NJAZ-eve, atëherë e drejta e ankimit, sipas kësaj pike, fillon me ankimin administrativ, në përputhje me nenin 124 të këtij Kodi.”

#### **Neni 115**

Neni 146 ndryshohet si vijon:

“Neni 146

Afati i ankimit në gjykatë dhe përbërja e trupës gjyqësore

1. Ankimi për të gjitha vendimet që KQZ-ja merr në periudhën, e cila fillon 48 orë pas dekretimit të zgjedhjeve të pjesshme ose të përgjithshme deri në përfundim të shqyrtimit administrativ të ankimeve zgjedhore ose të kalimit të afateve të ankimit për zgjedhje, bëhet brenda 3 ditëve nga shpallja e tyre.
2. Afati i ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit për vendimet që KQZ-ja merr jashtë periudhës së përcaktuar në paragrafin e parë të këtij neni është 30 ditë nga data e miratimit të tij.
3. Ankimi kundër aktit nënligjor normativ të KQZ-së duhet të paraqitet në Gjykatën administrative të Apelit Tiranë brenda 3 vjetëve nga data e hyrjes në fuqi të aktit. Ankimi kundër aktit nënligjor normativ të KQZ-së që miratohet nga KQZ-ja në periudhën e cila fillon 48 orë pas dekretimit të zgjedhjeve të pjesshme ose të përgjithshme deri në përfundim të shqyrtimit administrativ të ankimeve zgjedhore ose të kalimit të afateve të ankimit për zgjedhje, bëhet brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.
4. Ankimi kundër vendimeve të KQZ-së shqyrtohet nga Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë nga një trupë e përbërë nga tre gjyqtarë, kurse ankimi ndaj akteve me karakter nënligjor normativ të KQZ-së shqyrtohet nga një trupë e përbërë prej 5 gjyqtarësh.”

#### Neni 116

Neni 147 ndryshohet si vijon:

“Neni 147

#### Forma dhe përmbajtja e ankimit

Ankimi bëhet në formën e kërkesë padisë. Kërkesë-padia shkruhet në gjuhën shqipe dhe duhet të përmbajë:

- a) gjykatën përpara së cilës paraqitet kërkesa;
- b) emrin, atësinë, mbiemrin, vendbanimin ose vendqëndrimin e paditësit, e të paditurit dhe të personave që përkatësisht i përfaqësojnë ata, kur ka të tillë, duke treguar edhe selinë ose zyrën qendrore, ku do kryhet njoftimi;
- c) objektin e kërkesë padisë;
- ç) tregimin konkret të fakteve, rrethanave, dokumenteve, mjeteve të tjera provuese, të së drejtës mbi të cilat mbështetet padia, si dhe kërkimin konkret të paditësit;
- d) të dhënat elektronike të kontaktit të tij ose të përfaqësuesit ku gjykata mund ta njoftojë;
- dh) provat që kërkohen të merren nga i padituri dhe të tretët, duke përcaktuar arsyet dhe vendndodhjen e këtyre provave;

- e) nëse kërkon, llojin e ekspertimit që kërkohet të kryhet gjatë gjykimit;
- ë) emrin, atësinë, mbiemrin ose emërtimin nëse është person juridik dhe adresën e plotë të personave të tretë që kërkon të thirren në gjykim me këtë cilësi. Palë të treta janë palët pjesëmarrëse në shqyrtimin administrativ pranë KQZ-së;
- f) aktin provues të pagimit të tarifës së padisë, sipas ligjit.”

#### **Neni 117**

Neni 148 ndryshohet si vijon:

“Neni 148

Paraqitja e kërkesëpadiës dhe hedhja e shortit

1. Kërkesë padia paraqitet në gjykatë nga paditësi ose nga përfaqësuesi i tij i pajisur me autorizim dhe rregjistrohet. Kërkesëpadia mund të paraqitet në gjykatë edhe nëpërmjet postës.
2. Kërkesëpadia i caktohet gjyqtarit relator me short. Mënjëherë pas hedhjes së shortit për gjyqtarin relator hidhet shorti për anëtarët e tjerët të trupës gjyquese.
3. Gjyqtari relator është edhe kryesues i trupës gjyquese të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.”

#### **Neni 118**

Neni 149 ndryshohet si vijon:

“Neni 149

Veprimet përgatitore

1. Për zhvillimin e gjykimit, sipas parimit të një procesi të rregullt gjyqësor dhe brenda afateve të shpejta e të arsyeshme, gjyqtari relator, brenda 24 orëve nga data e paraqitjes së kërkesëpadiës, kryen këto veprime:
  - a) I kërkon paditësit plotësimin e të metave të kërkesëpadiës, duke i caktuar atij një afat, deri në 48 orë. Kur paditësi nuk plotëson të metat e padisë, brenda afatit të caktuar, gjyqtari merr vendim për kthimin e kërkesëpadiës dhe të akteve që i bashkëlidhen asaj.
  - b) I njofton të paditurit dhe personave të tretë kërkesëpadinë dhe aktet shoqëruese të saj, duke i caktuar atij një afat, deri në 24 orë nga data e marrjes së këtij njoftimi, për depozitimin në sekretari të prapësimeve me shkrim, si dhe të akteve të plota shkresore, në të cilat janë bazuar kryerja e veprimit administrativ dhe shqyrtimi i ankimit



administrativ. Në rastin e padisë me të meta, gjyqtari e dërgon këtë njoftim për të paditurin dhe personat e tretë në datën e plotësimit të të metave nga paditësi.

c) Paditësi dhe I Padituri njoftohen edhe për përbërjen e trupit gjykues për efekt të paraqitjes prej tyre të kërkesës për përjashtim të gjyqtarit sipas përcaktimeve të bëra në Kodin e Procedurës Civile. Kërkesa duhet të përmbajë shkaqet e përjashtimit, dokumentet dhe provat e tjera që disponohen, brenda 24 orësh nga data e marrjes së njoftimit. Kërkesa i drejtohet Kryetarit të Gjykatës Administrative të Apelit, i cili menjëherë hedh shortin për caktimin e një anëtari tjetër të gjykatës për shqyrtimin e saj. Kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit sipas kësaj shkronje shqyrtohet në dhomë këshillimi brenda 24 orësh nga hedhja e shortit. Vendimi i arsyetuar i njoftohet palëve dhe shpallet në ëbsitin zyrtar të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

2. Veprimet e paragrafit të parë të këtij neni të gjyqtarit relator kryhen me vendime të ndërmjetme dhe dokumentohen në procesverbalin e veprimeve përgatitore, që hartohet nga sekretari gjyqësor dhe nënshkruhen prej tij dhe gjyqtarit relator.

3. Mosparaqitja e palëve në veprime përgatitore nuk përbën shkak për pushimin e gjykimit të çështjes, edhe kur ata janë thirrur dhe njoftuar rregullisht.”

#### Neni 119

Neni 150 ndryshohet si vijon:

#### “Neni 150

#### Urdhëri për caktimin e seancës gjyqësore

1. Gjyqtari, pasi sigurohet për kryerjen e të gjitha veprimeve përgatitore, menjëherë nxjerr urdhrin për caktimin e seancës gjyqësore. Afati për zhvillimin e seancës gjyqësore nuk mund të jetë më i gjatë se 5 ditë nga data e rregjistrimit të kërkesëpadisë.
2. Urdhri për caktimin e seancës gjyqësore përmban:
  - a) datën, orën dhe vendin e zhvillimit të seancës gjyqësore;
  - b) palët dhe, sipas rastit, dëshmitarët dhe/ose ekspertët e kërkuar nga palët, që duhet të marrin pjesë në seancë gjyqësore;
  - c) në rast se gjyqtari vendos, ekspertët e caktuar prej tij;
  - ç) njoftimin dhe mënyrën e njoftimit të palëve dhe të personave, që duhet të marrin pjesë në seancë.
3. Njoftimi drejtuar palëve duhet të përmbajë paralajmërimin, që mosparaqitja e provave përpara seancës së parë gjyqësore shkakton mospranimin e tyre.”

## Neni 120

Neni 151 ndryshohet si vijon:

«Neni 151

Seanca gjyqësore

1. Seanca gjyqësore zhvillohet sipas neneve të Kodit të Procedurës Civile, ligjit «Për organizimin dhe funksionimin e gjykatës administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative» për atë që ato janë të pajtueshme me këtë ligj.
2. Mosparaqitja e palëve në seancën gjyqësore nuk shkakton shtyrjen apo pushimin e gjykimit.
3. Shqyrtimi i çështjes nga gjykata në seancë gjyqësore bëhet me shkrim, por palët mund të kërkojnë të parashtrajnë, me gojë, shpjegimet e tyre. Në këtë rast gjykata udhëzon palët që të citojnë vetëm çështjet faktike dhe ligjore që, sipas mendimit të saj, janë të rëndësishme për dhënien e vendimit edhe nëse ato nuk ishin referuar në kërkesëpadinë e paraqitur në parë.»

## Neni 121

Neni 152 ndryshohet si vijon:

“Neni 152

Llojet e vendimeve të Kolegjit Zgjedhor

1. Gjykata Administrative e Apelit në përfundim të shqyrtimit gjyqësor vendos:
  - a) pushimin e gjykimit;
  - b) gjykimin e çështjes në themel; ose
  - c) detyrimin e KQZ-së për të marrë vendim.
2. Pushimi i gjykimit vendoset kur Gjykata konstaton se ankimi është paraqitur jashtë afateve të përcaktuara në këtë ligj ose për mungesë kompetence. Kur Gjykata vendos mungesën e kompetencës, ia dërgon çështjen organit kompetent.
3. Me gjykimin e çështjes në themel, Gjykata vendos pranimin e plotë apo të pjesshëm të kërkesë padisë ose rrëzimin e saj.
4. Gjykata vendos detyrimin e KQZ-së për të marrë vendim, në zbatim të pikës 2 të nenit 145 të këtij Kodi. Në këtë rast Gjykata cakton afat të prerë për marrjen e vendimit jo më të gjatë se 5 ditë.

5. Gjykata është e detyruar të zbardhë vendimin jo më vonë se tre ditë nga data e dhënies së tij. Vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit publikohet menjëherë në faqen e internetit të saj.”

## Neni 122

Neni 153 ndryshohet si vijon:

### “Neni 153

#### Rekursi në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë

1. Ndaj vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit mund të ushtrohet ankimi në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë brenda 3 ditësh nga data e njoftimit të vendimit gjyqësor të arsyetuar.
2. Ankimi depozitohet në Gjykatën Administrative të Apelit e cila ia njofton atë palëve në gjykim ankimin dhe i njofton se kanë të drejtën për të paraqitur kundërankim brenda 48 orësh nga marrja e njoftimit. Me plotësimin e këtij afati Kancelari i Gjykatës Administrative të Apelit përcjell brenda 24 dosjen gjyqësore në Gjykatën e Lartë.
3. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë e shqyrton çështjen në dhomë këshillimi brenda 3 ditësh nga data e regjistrimit të dosjes gjyqësore.
4. Në shqyrtimin e çështjes Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë zbaton përcaktimet e bëra në ligjin nr. 49/2012 për gjykimin prej tij në dhomë këshillimi.
5. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vendos:
  - a) mospranimin e rekursit dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit;
  - b) ndryshimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit;
  - c) prishjen e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit;
  - ç) pushimin e gjyqësorit të çështjes kur ankuesi heq dorë nga rekursi.
6. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk mund të rikthejë për rishqyrtim çështjen në Gjykatën Administrative të Apelit, por shqyron vetë themelin e çështjes për të cilën është paraqitur rekurs.
7. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë shpall vendimin e arsyetuar brenda 24 orësh nga momenti i marrjes së tij. Teksti i vendimit bëhet menjëherë publik në faqen e internetit të Gjykatës së Lartë.»

### **Neni 123**

Neni 154 ndryshohet si vijon:

“Neni 154

Procedura e shqyrtimit të kërkesëpadisë

Në shqyrtimin gjyqësor të kërkesë padive për të gjitha veprimet procedurale që nuk rregullohen nga ky ligj, Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, zbaton për aq sa është e mundur dispozitat e Kodit të Procedurës Civile për gjykimin e çështjeve në shkallën e parë dhe në ligjin “Për organizmin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

### **Neni 124**

Neni 155, neni 156, neni 157, neni 158 dhe neni 159 shfuqizohen.

### **Neni 125**

Në nenin 160, pika 4 fjala “KZAZ” zëvendësohet me “NJAZ”

### **Neni 126**

Në nenin 163, pika 6 shfuqizohet.

### **Neni 127**

Nenet 179, neni 179/1, neni 180, neni 180/1 dhe neni 183 shfuqizohen.

### **Neni 128**

Neni 181 ndryshohet si vijon:

“Neni 181

Zgjedhja e Komisionerit, Rregullatorit dhe KAS

(Ky nen duhet të punohet pasi Komisioni i Reformës Zgjedhore të diskutojë formulën e kompozimit të parë të KQZ-së, pas hyrjes në fuqi të ligjit)

### **Neni 129**

Neni 182 ndryshohet si vijon:

“Neni 182

Dispozitë tranzitore për shqyrtimin gjyqësor të mosmarrëveshjeve zgjedhore

Deri në datën 1 shtator 2022 shqyrtimi gjyqësor i ankimeve gjyqësore sipas Kreut I, Pjesa XI të këtij ligji, do të kryhet nga Kolegji Zgjedhor. Shqyrtimi gjyqësor i ankimeve nga Kolegji Zgjedhor bëhet në përputhje me përcaktimet e bëra në Aneksin që i bashkëlidhet këtij ligji.”

### **Neni 130**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Kryetar**  
**Gramoz RUÇI**

## ANEKS

### Kolegji Zgjedhor dhe konstituimi i tij

1. Kolegji Zgjedhor përbëhet nga tetë gjyqtarë të përzgjedhur me short nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.
2. Në shortin e hedhur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor për përzgjedhjen e tetë gjyqtarëve, që përbëjnë Kolegjin Zgjedhor, përfshihen emrat e të gjithë gjyqtarëve të të gjitha gjykatave të apelit të Republikës së Shqipërisë, gjykatat administrative të shkallës së parë dhe të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.
3. Në rast se një gjyqtari i Kolegjit Zgjedhor nuk konfirmohet në detyrën e gjyqtarit për shkak të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve siaps ligjit nr. 84/2016, vakanca e krijuar për këtë shkak plotësohet në përputhje me përcaktimet e bëra në këtë Aneks jo më vonë se 15 ditë nga krijimi i saj.
4. Shorti për përzgjedhjen e tetë gjyqtarëve të Kolegjit Zgjedhor hidhet jo më vonë se 45 ditë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. Shorti hidhet në praninë e publikut, përfaqësuesve të KQZ-së, partive politike, organizatave jofitimprurëse me fushën e veprimtarisë në çështjet e zgjedhjeve dhe të medias. Shorti zhvillohet duke tërhequr emrat e tetë gjyqtarëve nga kutia e shortit. Para fillimit të tij, të pranishmëve u jepet mundësia të këqyrin kutinë e shortit dhe emrat e gjyqtarëve të futur në të. Pas këqyrjes, nxirren tetë emra nga kutia. Ata përbëjnë Kolegjin Zgjedhor dhe delegohen në këtë detyrë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor menjëherë pas hedhjes së shortit.
5. Brenda 10 ditësh nga përzgjedhja e tyre me short, të tetë gjyqtarët e Kolegjit Zgjedhor bëjnë betimin në një ceremoni publike, në prani të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Betimi ka përmbajtjen që vijon: *“Betohem solemnisht se do të respektoj, do të mbroj dhe do t'i bindem Kushtetutës dhe ligjeve të Republikës së Shqipërisë, se do të respektoj të drejtat dhe liritë e qytetarëve dhe do të përmbush detyrat e mia. Betohem se do të kryej detyrën time me të gjitha mundësitë e mia dhe në mënyrë të paanshme, të drejtë dhe pa favorizuar ndonjë person, parti politrike apo subjekt zgjedhor”*.
6. Konstituimi i Kolegjit bëhet menjëherë pas betimit dhe thirret në detyrë nga Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Kolegji Zgjedhor qëndron i mbledhur deri në datën 1 korrik 2022.
7. Gjykata e Apelit, Tiranë vë në dispozicion të Kolegjit Zgjedhor mjedise të mjaftueshme pune, pajisje dhe personel, në mënyrë që të sigurojë kryerjen në kohë dhe në mënyrë profesionale të detyrave të veta.
8. Me kërkesë të Kryetarit të Gjykatës së Apelit Tiranë, Kolegji rithirret në detyrë sa herë që pranë kësaj gjykate depozitohen ankime ndaj vendimeve të KQZ-së, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 146 të këtij ligji.

### Shqyrtimi i ankimeve nga Kolegji Zgjedhor

1. Ankimet sipas nenit 145 të këtij ligji paraqiten në formën e kërkesëpadisë dhe depozitohen në Gjykatën e Apelit, Tiranë, e cila ia kalon ato Kolegjit Zgjedhor.
2. Kërkesë padia përmban elementët e parashikuar në nenin 147 të këtij ligji.
3. Kolegji Zgjedhor gjykon me trup gjykues të përbërë nga 5 gjyqtarë. Relatori i çështjes kryeson trupin gjykues.
4. Kolegji Zgjedhor njihet me kërkesëpadinë jo më vonë se 24 orë nga dërgimi i saj dhe:
  - a) merr vendim për kërkesën e paditësit për përjashtimin e gjyqtarit;
  - b) hedh shortin për përbërjen e trupit gjykues dhe relatorin e çështjes; dhe
  - c) cakton datën dhe orën e fillimit të shqyrtimit gjyqësor.
5. Relatori, menjëherë pas caktimit, kryen veprimet paraprake të mëposhtme:
  - a) njofton palët për datën dhe orën e gjykimit të çështjes dhe përbërjen e trupit gjykues;
  - b) sipas rastit, i kërkon paditësit plotësimin e kërkesëpadisë, jo më vonë se 24 orë para datës së caktuar për shqyrtim gjyqësor;
  - c) u dërgon palëve të interesuara kopje të kërkesëpadisë dhe i informon ato për të drejtën ligjore për të kërkuar përjashtimin e gjyqtarit të trupit gjykues, sipas Kodit të procedurës Civile. Palët e interesuara, kërkesën për përjashtimin e gjyqtarit duhet ta paraqesin brenda 24 orëve nga marrja e njoftimit, sipas shkronjës “a” të kësaj pike. Kërkesat, sipas kësaj shkronje, shqyrtohen nga Kolegji Zgjedhor në dhomë këshillimi brenda 24 orëve nga depozitimi i kërkesës;
  - ç) në rast se KQZ-ja nuk ka lëshuar vendimin, sipas nenit 144 të këtij ligji, i kërkon asaj të depozitojë vendimin në gjykatë jo më vonë se 24 orë para datës së caktuar për shqyrtimin gjyqësor.

#### Të drejtat e palëve në proces

1. Palët në procesin e shqyrtimit gjyqësor të kërkesëpadisë kanë të gjitha të drejtat procedurale, që parashikohen në Kodin e Procedurës Civile, përveç rastit kur parashikohet ndryshe në këtë Kod.
2. KQZ-ja sjell në gjykim të gjitha provat e administruara prej saj gjatë shqyrtimit administrativ, pavarësisht nga kërkesat e palëve për to, si dhe çdo provë tjetër që Kolegji Zgjedhor kërkon.
3. Kur gjatë hetimit gjyqësor kanë dalë fakte apo prova të reja, për të cilat paditësi nuk mund të kishte dijeni përpara se të paraqitej kërkesëpadia, me kërkesë të paditësit objekti i padisë mund të shtohet apo ndryshohet përpara se Kolegji Zgjedhor t'i japë fund hetimit gjyqësor. Kërkesa mund të përfshijë ndryshimin e tabelës së rezultatit ose pavlefshmërinë e zgjedhjeve në qendër/qendra votimi.
4. Mungesa e njëres palë gjatë procesit nuk përbën pengesë për vazhdimin e gjykimit nga ana e Kolegjit Zgjedhor, përveç rastit kur kolegji vendos ndryshe.

#### Afati i gjykimit dhe llojet e vendimeve të Kolegjit Zgjedhor

Afati i gjykimit dhe llojet e vendimeve që merr Kolegji Zgjedhor në përfundim të shqyrtimit gjyqësor janë sipas nenit 152 të këtij ligji. Kolegji Zgjedhor është i detyruar të zbardhë

vendimin jo më vonë se tre ditë nga data e dhënies së tij. Vendimi i Kolegjit publikohet menjëherë në faqen e internetit të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Vendimet e Kolegjit Zgjedhor janë përfundimtare dhe ndaj tyre nuk mund të bëhet ankim.

[shqiptarja.com]